

REPUBLIKA E SHQIPERISE
Keshilli i Ministrave

VENDIM

Nr. 579 date 23.8.2006

PER KRIJIMIN E AGJENCISE SE MJEDISIT DHE PYJEVE

Ne mbeshtetje te nenit 100 te Kushtetutes, te neneve 12 e 13, te ligjit nr.7893, date 22.12.1994, "Per shkencen dhe zhvillimin teknologjik", te ndryshuar, te nenit 10, te ligjit nr.9000, date 30.1.2003, "Per organizimin dhe funksionimin e Keshillit te Ministrave", te shkronjes "c", te nenit 15, te ligjit nr.8743, date 22.2.2001, "Per pronat e paluajtshme te shtetit", dhe te ligjit nr.9464, date 28.12.2005, "Per buxhetin e shtetit, te vitit 2006", me propozimin e ministrit te Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit te Ujerave, Keshilli i Ministrave

VENDOSI:

1.Krijimin Agjencise se Mjedisit dhe Pyjeve, nga reformimi i Institutit te Mjedisit dhe Institutit te Kerkimeve te Pyjeve dhe Kullotave, si nje institucion juridik, publik, buxhetor, ne varesi te ministrit te Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit te Ujerave.

2. Agjencia e Mjedisit dhe Pyjeve e ka seline ne Tirane, ne ndertesen e ish-Institutit te Kerkimeve te Pyjeve dhe Kullotave, si dhe ka vulen e vet.

3. Fusha e veprimtarise se Agjencise se Mjedisit dhe Pyjeve eshte:

a. Sigurimi i mbeshtetjes teknike, i sherbimeve dhe keshillimi per Ministrine e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit te Ujerave.

b. Grumbullimi, perpunimi dhe informimi i publikut per rezultatet e monitorimit, ne fushen e mjedisit dhe pyjeve.

4. Numri i punonjesve buxhetore te Agjencise se Mjedisit dhe Pyjeve, per vi tin 2006, te jete 47 veta.

5. Instituti i Kerkimeve te Peshkimit dhe qendra e rritjes se rasateve te peshkut ne Tapize, Tirane, kalojne ne administrim dhe varesi te Ministrise se Arsimit dhe Shkences, (Universiteti Bujqesor, Tirane).

6. Qendrat e rritjes se rasateve te peshkut ne Lin, Pogradec, dhe Zvezde, Korce, te mbeten ne varesi te Ministrise se Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit te Ujerave.

7. Pajisjet, dokumentacioni, fondet buxhetore dhe vierat e tjera monetare te Institutit te Mjedisit, Institutit te Kerkimeve te Pyjeve dhe Kullotave e te Institutit te Kerkimeve te Peshkimit dhe te qendres se rritjes se rasateve te peshkut ne Tapize, Tirane, ne baze te bilancit kontabel ne daten e dorezimit, t'u kalojne, perkatesisht, Agjencise se Mjedisit dhe Pyjeve dhe Universitetit Bujqesor, Tirane.

8. Dorezimi dhe marrja ne dorezim e ketyre pajisjeve, dokumentacionit, alokimi dhe rialokimi i fondeve buxhetore sipas institucioneve perkatese dhe e vlerave te tjera monetare, te behen nga nje komision i perbashket me perfaqesues te Ministrise se Financave, Ministrise se Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit te Ujerave dhe te Ministrise se Arsimit dhe Shkences.

9. Efektet financiare, qe rrjedhin nga zbatimi i ketij vendimi, per vitin 2006, te perballohen nga buxheti i shtetit, i ketij viti, miratuar per Ministrine e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit te Ujerave.

10. Vendimet nr.659, date 18.12.2002, "Per krijimin e Institutit te Mjedisit", nr.371, date 22.8.1992, "Per krijimin e Institutit te Kerkimeve te Pyjeve dhe Kullotave", dhe nr.544, date 29.12.1992, "Per krijimin e Institutit te Peshkimit", te Keshillit te Ministrave, shfuqizohen.

11. Ngarkohen ,Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit te Ujerave dhe Ministria e Arsimit dhe Shkences per zbatimin e ketij vendimi.

Ky vendim hyn ne fuqi menjehere.

KRYEMINISTRI
SALI BERISHA

MINISTRI I MJEDISIT, PYJEVE DHE ADMINISTRIMIT TE UJERAVE
LUFTER XHUVELI